

FAKTE PËR PËRDORIMIN E DUHANIT

Çdo vit rreth 8 milionë njerëz vdesin si rezultat i përdorimit të duhanit


7 milionë nga përdorimi i drejtpërdrejtë, ndërsa 1.2 milionë si pasojë e ekspozimit pasiv ndaj produkteve të duhanit

Pirja pasive e duhanit - ekspozimi ndaj tymit ose avullit të çfarë do produkti të duhanit

9 nga 10 duhanpirës kanë filluar të pinë duhan para se të mbushin 18 vjet

Përdorimi i duhanit tek të rinjtë zvogëlon funksionin dhe zhvillimin e mushkërive, që ndikon në shfaqjen e sëmundjeve kronike

Nikotina shkakton varshmëri dhe dëmtime afatgjata të rënda të trurit.




REKOMANDIME

Instituti i Shëndetit Publik në pajtim me rregullativën ligjore, rekomandon:

- ➔ Ndalesë të plotë të përdorimit të produkteve të duhanit brenda shkollës dhe në zonën në afërsi të saj
- ➔ Zbatimin e rregullt të programeve për edukimin e nxënësve si pjesë e kurrikulave mësimore, në të cilat flitet për parandalimin e përdorimit të duhanit
- ➔ Formimin e shërbimeve për ndihmë gjatë procesit të lënies së pirjes së duhanit në kuadër të vetë shkollës
- ➔ Ndalimin e shitjes së produkteve të duhanit në objekte që janë afër shkollave
- ➔ Ndjekjen aktive të situatës dhe rekomandimeve nga shkollat

Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut



LLOJET E PRODUKTEVE TË DUHANIT

Duhan për pirje - këtu bëjnë pjesë të gjitha produktet e duhanit që pihen (cigaret, purot, etj.)

Duhan që nuk është për pirje – produkte të duhanit që përtypen ose që merren nëpërmjet të hundës

Duhan i padjegshëm – këto produkte përdoren me një pajisje të veçantë (lqos, lilsolid), e për momentin janë shumë në modë.

Cigaret elektronike (E-cigaret) - pajisje që ngrohin lëngun që përmban nikotinë, me ç'rast lirohet avull



PËRFITIME PËR NXËNËSIT

Mospërdorimi i duhanit tek nxënësit u mundëson atyre shumë përfitime:

Jeta pa duhan i ndihmon nxënësit të zhvillojnë shprehi të shëndetshme të jetesës

Nëse një numër më i madh i nxënësve nuk janë duhanpirës, kjo gjë i zvogëlon gjasat që nxënësit e tjerë të përdorin duhan

Krijojnë një mjedis ku ekspozimi ndaj pirjes pasive të duhanit është pothuajse inekzistent

Denormalizohet përdorimi i duhanit, pra pirja e duhanit bëhet e papranueshme në shoqëri



PËRFITIMET PËR SHKOLLAT

Mospërdorimi i duhanit në shkolla ndikon pozitivisht, ashtu që:

Ambientet pa tym mundësojnë zhvillim intelektual më të shpejtë dhe më të shëndetshëm të nxënësve

Zvogëlohet rreziku nga zjarret, si dhe nga sëmundjet profesionale që janë si pasojë e përdorimit të duhanit

Zvogëlohet ekspozimi ndaj pirjes pasive të duhanit për të gjithë kolektivin nëpër shkolla

Jepet një shembull i mirë për atë se si duhet të zhvillohet dhe mirëmbahet një mjedis i shëndetshëm dhe pozitiv

